



METODOLOGJIA E LLOGARITJES SE DEMIT EKONOMIK SHKAKTUAR KOMPANISE SE SHPERNDARJES NGA NDERHYRJET E PALIGJSHME

(Miratuar me Vendimin Nr. 42 datë 22.04.2011)

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj Metodologjie është përcaktimi i dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme.

2. Objekti

Kjo Metodologji do të jetë e zbatueshme në rastet kur një entiteti të caktuar me ligj i duhet të llogarisë dëm ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të kompanisë së shpërndarjes.

3. Baza Ligjore

Baza ligjore për hartimin e kësaj metodologjie është Ligji Nr. 9072, date 22.05.2003” Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, i ndryshuar, neni 8, pika “d” dhe neni 51, pika “14”.

4. Përcaktimi i Dëmit Ekonomik

Dëmi ekonomik është vlera korresponduese në Leke e sasisë së energjisë elektrike (KWh) të konsumuar mesatarisht gjatë një viti prej një konsumatori/klienti tipik të secilës kategori.

Sasia e energjisë së konsumuar është llogaritur si produkt i konsumit mesatar mujor të një konsumatori/klienti tipik, të kategorisë ku shkaktari i dëmit bën pjesë, me numrin e muajve të një viti (12) dhe përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

<u>Kategoritë e Klientëve</u>	Sasia (KWh)
<u>Kategoria e Pare- Klientë te Vegjël</u> Matës Mono-faze elektro-metër,	4.000
<u>Kategoria e Dytë-Klientë te Mesëm</u> Matës Tre-Fazore, deri në 30 kW	10.000
<u>Kategoria e Tretë-Klientë te Mëdhenj</u> Matës Tre –Fazore, mbi 30 kW	20.000

Çmimet që do të aplikohen për këto sasi të llogaritura të dëmit ekonomik do të jenë çmimet e energjisë elektrike të zbatuara në periudhën jashtë pikut, miratuara nga ERE, për kategoritë e klientëve sipas nivelit të tensionit ku ato furnizohen. Për klientët familjarë do të aplikohet çmimi i miratuar për sasinë e energjisë elektrike të konsumuar në bllokun e dytë.

5. Hyrja në Fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi menjëherë.